

## **Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) miraton kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: Si do vlerësohen dhe përzgjidhen 27 prokurorët kandidatë në PP**

- *Çfarë parashikon rregullorja tranzitore për vlerësimin dhe përgjedhjen e kandidatëve prokurorë në Prokurorinë e Posaçme? Disa nga afatet e parashikuara kohore dhe kriteret për vlerësimin e tyre*

Përfundimi i afatit në datën [21 shkurt 2019](#) për dorëzimin e aplikimeve për 15 pozicionet vakante prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, solli rregjistrimin e [27 kandidatëve](#) për këto pozicione, dhe në të njëjtën kohë shënoi edhe fillimin e procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e tyre. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) është organi përgjegjës, i cili fillimisht duhet të shqyrtojë dokumentacionin e kandidatëve aplikantë dhe më pas do të bëjë përzgjedhjen e tyre. Por, përpara emërimit përfundimtar në PP, KLP do të kërkojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) të mundësojë rivlerësimin me përparësi të listës së kandidatëve të përgjedhur. Vendimi i KPK-së është përcaktues për emërimin përfundimtar të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme.

Në këtë mënyrë, në përmbushje të kompetencave për vlerësimin e 27 kandidatëve prokurorë dhe përzgjedhjen e tyre, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përfundoi gjatë kësaj periudhe [hartimin](#) e rregullores së detajuar, e cila përcakton metodologjinë e plotë për vlerësimin e kandidatëve dhe përzgjedhjen e tyre. Në [seancën plenare nr. 8](#) të datës 19 mars, Këshilli vendosi në rendin e ditës ndër të tjera edhe miratimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

Rregullorja për ngritjen në detyrë të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme do të shërbejë si një rregullore tranzitore deri në krijimin e institucionit më të rëndësishëm të hetimit. Pas kësaj vetë Prokuroria e Posaçme do të duhet të hartojë dhe miratojë rregulloren e saj të brendshme. Për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, rregullorja parashikon ngritjen dhe funksionimin e një Komisioni të Posaçëm të përbërë nga 5 anëtarë. Ky komision do të ketë të drejtën të propozojë KLP-së emrat e kandidatëve, të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në rregullore sipas një vlerësimi me 3 shkallë. Edhe ky Komision do të funksionojë deri në përmbushjen e qëllimit për të shqyrtuar, vlerësuar dhe propozuar kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

Ndër [kriteret kryesore](#) që parashikohen në rregullore në lidhje me vlerësimin e kandidatëve do të jenë: kualifikimi i lartë i prokurorëve, integriteti i tyre, aftësia e tyre për mbrojtjen e akuzës në gjykatë, por edhe një raport, i cili do ti kërkohet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nëpërmjet të cilët ky institucion do ti referojë KLP-së histori suksesi të prokurorëve kandidatë për në prokurorinë e Posaçme. KLP vendosi shqyrtimin e 5 dosjeve për secilin kandidat për prokurorë të posaçëm, ndërkohë që procedurat e vlerësimit parashikojnë një sistem pikëzimi, i cili do të aplikohet sipas rregullave të detajuara në rregullore.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka parashikuar që procesi i shqyrtimit të dosjeve dhe dokumentacionit për 27 kandidatët prokurorë në Prokurorinë e Posaçme të zgjasë rreth 6 javë. Ndërkohë për 1 deri në 2 javë është parashikuar të realizohet procesi i intervistimit të kandidatëve. Lidhur me këtë të fundit në [mbledhjen e datës 19 mars](#) ka patur diskutime dhe mendime të kundërta ndërmjet anëtarëve të Këshillit në lidhje me pëfshirjen e përfaqësuesve të OPDAT dhe EURALIUS për të drejtuar pyetje gjatë intervistave të kandidatëve për prokurorë në PP. Megjithatë, në përfundim anëtarët e KLP-së [votuan dhe mbështetën variantin](#), i cili i jep të drejtë përfaqësuesve dhe ekspertëve të OPDAT dhe EURALIUS ti drejtojnë pyetje kandidatëve për në Prokurorinë e Posaçme.

Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” u miratua unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Këshillit dhe pritet të botohet së shpejti në fletoren zyrtare. Pas përzgjedhjes së prokurorëve kandidatë në PP, kalimit të vettingut dhe emërimit të tyre në Prokurorinë e Posaçme është parashikuar të fillojnë edhe procedura për zgjedhjen e drejtuesit të SPAK, duke sjellë në këtë mënyrë funksionimin e shumëpritur të një prej organeve më të rëndësishme të hetimit në vend për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

- *Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) fillon procedurat e rivlerësimit për 6 kandidatë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (PP)*

Megjithëse procesi i shqyrtimit të dosjeve të 27 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme është parashikuar të zgjasë rreth 6 javë, fillimi i procedurave të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për këta kandidatë do ti paraprinte vonesave, të cilat lidhen me rivlerësimin e tyre dhe vendimin e KPK-së.

Listës së prokurorëve të Prokurorisë të Krimeve të Rënda, të cilët aplikuan për prokurorë të posaçëm (të konsideruar ndër kandidatët më potencialë për PP), i'u bashkëngjitën edhe prokurorë të tjera nga prokuroritë e Tiranës apo të rrethëve të tjera gjyqësore. Madje në listën e subjekteve, të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, u përfshinë edhe subjekte jashtë sistemit të prokurorisë.

Për këtë arsye, pas përfundimit të aplikimeve dhe shpalljes së emrave kandidatë për prokurorë në PP, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përfshirë në shortin e datës [15 mars 2019](#) edhe 6 emrat e kandidatëve për të cilët nuk kishte filluar ende procesi i rivlerësimit, duke përmbyllur listën me të gjithë emrat kandidatë. Aktualisht nga 27 aplikimet për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, vetëm dy prej tyre janë kandidatë jashtë sistemit të prokurorisë.

Deri tani Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka konfirmuar në detyrë vetëm 5 prokurorë, të cilët kanë aplikuar për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Në kalendarin e seancave dëgjimore të muajit mars nuk u përfshi asnjë nga kandidatët e tjerë për prokurorë në PP dhe për të cilët procedurat e rivlerësimit kanë filluar më parë në kohë.

- *Këshilli i Lartë i Prokurorisë me 10 anëtarë: Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) shkarkon anëtarin e KLP-së Antoneta Sevdari. Prokuroria e Përgjithshme mbyll thirrjen për aplikime në datën 20 mars 2019*

Megjithëse ngritja e dy organeve të reja të drejtësisë ku përfshihen Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë ishte një ndër hapat më pozitivë të reformës, numri i lartë i ankimimit të vendimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA) për anëtarët aktualë të këtyre dy Këshillave, është konsideruar në vazhdimësi një problem shqetësues.

Siç është [shjellë në vëmendje](#) edhe më parë, për 3 nga 6 anëtarët e zgjedhur në KLP pritej konfirmimi përfundimtar nga KPA. Në datën 28 shkurt 2019 Kolegji i Posaçëm i Apelit [njoftoi vendimin](#) për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Antoneta Sevdari, duke vendosur ndryshimin e vendimit të KPK-së për subjektin dhe shkarkimin e saj nga detyra dhe duke bërë si rrjedhojë të pamundur ushtrimin e funksionit si anëtare e KLP-së.

Në vijim të procedurave, Prokuroria e Përgjithshme shpalli në datën 5 mars 2019 [thirrjen](#) për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në të cilën [përcaktohej](#) dokumentacioni respektiv për prokurorë nga Prokuroritë e Shkallës së Parë. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit ishte data 20 mars 2019.

Me përfundimin e këtij afati [vetëm prokurori Vatë Staka](#) ka shprehur interes për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Prokurori Staka rikandidon për herë të dytë për të qenë pjesë e këtij institucioni, pasi ishte një nga kandidatët për anëtarë prokurorë në KLP edhe përpara ngritjes të këtij organi. Megjithatë [Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve](#) e mbajtur në [11 dhjetor 2018](#) nuk e përzgjedhi si anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Prokurori Vatë Staka është gjithashtu një nga [subjektet kandidatë](#) për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, ndërkohë që [u konfirmua](#) nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në Korrik 2018.

Ende dy anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prokurorët Gentian Osmanaj dhe Arben Dollapaj nuk kanë marrë vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi më i rëndësishëm për menaxhimin e sistemit të prokurorisë po ushtron aktualisht kompetenca të rëndësishme në drejtim të ngritjes së Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK). Si rezultat i ngarkesës dhe përgjegjësive të rëndësishme në këtë drejtim, anëtarët dhe stafi përbëjnë një faktor të rëndësishëm në mbarvajtjen dhe menaxhimin e punës së institucionit.

	<b>Prokurorët kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme (PP)</b>		<b>Vendimi i KPK</b>
1.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
2.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
4.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
5.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
6.	Eugen Beci	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
7.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
8.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Konfirmuar
9.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
10.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar
11.	Shkelzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës	Në proces
12.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
13.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
14.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
15.	Vatëë Staka	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Konfirmuar
16.	Fatmir Hoxhaj	Drejtor-Drejtorja e Administrimit të Pronës Shtetërore, Ministria e Financave (ish-prokuror)	Kandidat jo-prokuror
17.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Në proces
18.	Enkeleda Osmani (Xhengo)	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
19.	Elida Kaçkini (Celami)	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
20.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Në proces
21.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
22.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Konfirmuar
23.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Në proces
24.	Irena Nino (Vujoshi)	Anëtare e perkohshme pranë Komisionit të Monitorimit të Reformës në Drejtësi	Kandidate jo-prokurore
25.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
26.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
27.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)

\* Lista e plotë e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (PP). Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), <http://klp.all/wp-content/uploads/2019/02/lista-e-aplikimeve-per-SPAK.pdf>